




POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1




Lushnje/ Aksident me vdekje në aksin Çermë-Divjakë, humb jetën 38-vjeçari! 4 të plagosur, mes tyre 2 fëmijë (EMRI+VIDEO)
- 2



Drake vendos bast 1.5 milionë dollarë për Argentinën, rikthehet frika nga 'mallkimi i këngëtarit'
- 3



Botërori 2026/ Sonte shkruhet historia, do të luhet finalja Spanjë - Argentinë! Messi letër popullit argjentinës: Ndjeheuni krenarë
- 4



Sukseset nuk kanë fund për të! Ja triumfi i radhës i Dua Lipës në Britani
- 5



'Djali i ditëlindjes', Rita Ora dedikim të ëmbël për bashkëshortin e saj

Kronikë

Zbulohet bazë me armë e municion luftarak në Durrës, arrestohet 20-vjeçari! Furnizonte grupet kriminale (VIDEO)

Sekuestrohen 4 pistoleta, 1 kallashnikov, 1 armë gjahu (shotgun), 6 krehëra, qindra fishekë luftarakë, 1 targë automjeti italiane dhe 1 aparat celular.

Durrës: Zbulohet arsenal armësh, arrestohet 20-vjeçari

Report TV



Watch on

[Sh] Redaksia 19 Korrik, 10:03 | Përditësimi: 19 Korrik, 10:42

Share Post



Banesa e një 20-vjeçari në [Durrës](#) funksiononte si bazë ku mbaheshin armë zjarri dhe municion luftarak, që dyshohet se shërbenin për furnizimin e grupeve kriminale.

Policia njofton se i riu [Ergis Pepa](#) është arrestuar në flagrancë gjatë operacionit policor, ndërsa në banesë u gjetën dhe u sekuestruan 4 armë zjarri pistoletë, 1 armë zjarri automatike model 56 (kallashnikov), 1 armë gjahu (shotgun), 6 krehëra, qindra fishekë luftarakë të kalibrave të ndryshëm, 1 targë automjeti italiane dhe 1 aparat celular.

Armët do t'i nënshtrohen ekspertimit në Institutin e Policisë Shkencore, për të verifikuar nëse janë përdorur në ngjarje kriminale të ndodhura më parë.



LEXO EDHE:
Do bënin kontroll në resort, administratori dhe 4 punonjësit marrin peng inspektorët e Tatimeve! Arrestohen nga policia (EMRAT)

Njoftimi i plotë i policisë:

Në vijim të punës për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje dhe parandalimin e ngjarjeve të rënda kriminale, bazuar edhe në informacionet e siguruar në rrugë operative, shërbimet e Stacionit të Policisë Manzhë, në bashkëpunim me strukturat operationale të DVP Durrës, organizuan dhe finalizuan me sukses operationin policor të koduar “Baza”.

Si rezultat i këtij operacioni u zbulua një bazë ku mbaheshin armë zjarri dhe municion luftarak, që dyshohet se shërbenin për furnizimin e grupeve kriminale.

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit E. P., 20 vjeç, banues në Manzhë, Durrës, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, 4 armë zjarri pistoletë, 1 armë zjarri automatike model 56 (kallashnikov), 1 armë gjahu (shotgun), 6 krehëra, qindra fishekë luftarakë të kalibrave të ndryshëm, 1 targë automjeti italiane dhe 1 aparat celular.

Në përfundim të veprimeve procedurale u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit E. P.

Armët do t'i nënshtrohen ekspertimit në Institutin e Policisë Shkencore, për të verifikuar nëse janë përdorur në ngjarje kriminale të ndodhura më parë.

Vijon puna për identifikimin dhe nxjerrjen përpara përgjegjësisë ligjore të personave të tjerë të përfshirë në këtë veprimtari kriminale.

Materialet procedurale do t'i referohen Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për veprat penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.

K.M/E.H/Shqiptarja.com

TAG: Durrës Ergis Pepa

Komento

Komente



Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës: Finalja Spanjë-Argjentinë, kush e fiton Kupën e Botës?

18 Korrik, 19:55

Spanja Argjentina Nuk kam mendim

Lajme të tjera



U arrestua për vjedhjen e 700 mijë € në Postën e Durrësit, zbardhet dëshmia e ish-drejtoreshës: Si u përplasa me Valbona Dunin, transportonte paratë pa mjet të blinduar! Ja urdhri që dhashë

18 Korrik, 17:46



Gjykata la në burg ish-drejtoreshën e filialit të Postës së Durrësit, avokati: Vendim absurd, nuk ka prova që i ka marrë ajo lekët

18 Korrik, 15:07




Mbi 700 mijë € u vodhën në Postën e Durrësit, në burg ish-drejtoresha Mataj! Prokurori: Dyshohet se luante bixhoz! Paratë futeshin me thasë në zyrën e saj




Artur Korriku

18 Korrik, 11:49



Rritet fluksi në portin e Durrësit, 5 mijë emigrantë e turistë mbërrijnë sot vetëm me tragete

18 Korrik, 09:50




Vodhi 100 000 lekë në një biznes në Durrës, arrestohet 37-vjeçari

17 Korrik, 20:57



Në kërkim ndërkombëtar për trafik droge, 2 të arrestuar në Durrës! Priten të ekstradohen drejt Italisë dhe Spanjës (EMRAT)

17 Korrik, 11:10



Tentoi të vidhte një market duke thyer xhamat me çekiq, ndalohet 14-vjeçari në Krujë (VIDEO)

16 Korrik, 14:51



Anija turistike ‘Seven Seas Splendor’ ankorohet për herë të parë në portin e Durrësit! 650 turistë në bord

16 Korrik, 12:13



Durrës/ Vodhën 69 mln lekë nga vodhën në Postën e Durrësit, në burg ish-drejtoresha Mataj! Prokurori: Dyshohet se luante bixhoz! Paratë futeshin me thasë në zyrën e saj

16 Korrik, 09:09



Thyen ‘arrestin në shtëpi’ dhe vjedh me dhunë farmacinë! 45-vjeçari prangoset pas disa orësh! Momenti kur i sullet farmacistes në befasi (EMRI+VIDEO)

15 Korrik, 11:02



Posta Shqiptare kallëzon punonjësit, dyshohet se vodhën mbi 700 mijë euro në filialin në Durrës! Shkarkohet drejtoresha

14 Korrik, 14:04



Plagosja e 22-vjeçarit në Fushë-Krujë, arrestohet autori! I gjendet edhe thika me të cilën kreu krimin (EMRI)

14 Korrik, 10:10

×

[Sh] Lajmi i fundit



Drake vendos bast 1.5 milionë dollarë për Argentinën, rikthehet frika nga 'mallkimi i këngëtarit'

19 Korrik, 18:54

×

[Sh]

.com

Lajmi i fundit



Drake vendos bast 1.5 milionë dollarë për Argjentinën, rikthehet frika nga 'mallkimi i këngëtarit'

19 Korrik, 18:54